

A large, textured background image showing a landscape with a river, trees, and a person walking. Overlaid on this is a semi-transparent blue rectangle containing the title text.

PLANI I MBYLLJES DHE REHABILITIMIT

I VEND-DEPOZITIMEVE
ILEGALE NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE
RURALE LAKNAS,
BASHKIA KAMËZ

MELI

“Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërmes”

Tiranë, Shtator 2022

“Ky botim u realizua nga Reinforce Sustainability (RESU) në kuadër të projekti “Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërmes”, Komuniteti lokal për reduktimin e mbetjeve”, me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

“Metamorfoza e lumit Ishëm-Itinerari i së nesërmes”

Tiranë, Shtator 2022

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	2
PLANIFIKIMI I REHABILITIMIT	3
QËLLIMET KRYESORE TË REHABILITIMIT	4
QËLLIMET SPECIFIKE	4
2. KONCEPTE KRYESORE	5
3. KUADRI LIGJOR (SHQIPTAR)	5
4. KUADRI LIGJOR (EUROPIAN)	6
5. SITUATA E VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE BURIM NË ZONËN E LAKNASIT	6
VEND-DEPOZITIMET E IDENTIFIKUARA (SHTATOR 2022)	8
6. PLANI I MBYLLJES DHE REHABILITIMIT TË VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE BURIM	12
6.1. PLANI I MBYLLJES	13
6.1.1. OPSIONI PËR MBYLLJEN E VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE	14
TRANSPORTI NË LANDFILLIN E SHARRËS	14
TRANSPORTI NË NDONJË PIKË TRANSFERIMI TË MBETJEVE	15
MJETET TEKNOLOGJIKE TË NEVOJSHME PËR LARGIMIN E VEND-DEPOZITIMEVE	16
6.2. PLANI I REHABILITIMIT	18
PROCESI I REHABILITIMIT	18
SKEMAT E MBJELLJES	21
PROGRAMI I PROPOZUAR I AKTIVITETEVE PËR ZBATIMIN E KËTIJ PLANI	22

1. HYRJE

Ky Plan Rehabilitimi Mjedisor detajon një kornizë që synon të adresojë çështjet mjedisore që lidhen me rehabilitimin dhe trajton mbylljen e propozuar të vend-depozitimeve ilegale të mbetjeve në zonën rurale Laknas.

Njësia administrative rurale Laknas, është pjesë e bashkisë Kamëz. Sipërfaqja e zonës është 4,714,303 metër katrorë (4.7 km² ose 12.6% të sipërfaqjes së Bashkisë Kamëz). Rreth 70% e kësaj sipërfaqe është tokë arë, ku mund të zhvillohen aktivitete bujqësore, ndërsa pjesa tjetër është e zënë nga ndërtime dhe vepra infrastrukturore. Sipas të dhënave të bëra publike nga bashkia Kamëz deri në 2017 në këtë njësi jetonin 2069 familje ose 10880 banorë.

Kjo zonë përshkohet nga lumi i Tiranës dhe Lumi i Lanës, i cili është një rrjedhë mbetjesh urbane me aromë të rëndë, e cila e shoqëron pothuajse gjatë gjithë rrjedhës së tij. Lumi i Tiranës dhe përrrenjve Tërkuza dhe Zeza bashkohen duke formuar lumin Ishëm.



Figure 1 Vëndndodhja e NJ.A.R Laknas

Prej vitit 2018, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Kamëz ofrohet nga dy kompani private (95 % Alko Impex dhe 5 % 2T sh.p.k) për të gjithë territorin administrativ. Bashkia e Kamzës nuk ka një Plan Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për territorin gjeografik pas Reformës Territoriale Administrative. Edhe nga informacioni i marrë nga ENFORCE Albania, plani i fundit i Integruar për Menaxhimin e Mbetjeve që Bashkia Kamëz disponon është i vitit 2012. Për këtë arsye, një nga prioritetet kryesore në fushën e menaxhimit të mbetjeve është hartimi i politikës lokale (plani) si një prioritet themelor që do të rregullojë të gjithë kuadrin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në bashki, si dhe rregulloren e shërbimeve, të cilat do ta bëjnë planin lokal të zbatueshëm.

Vend-depozitimet ilegale përgjatë lumit, në zonën e Laknasit kanë qenë dhe janë një problem. Në raportin e studimit të vitit 2022, nga grupi ENFORCE Albania, në këtë zonë janë identifikuar 11 vend-depozitime ilegale duke e bërë zonën më të ndotur në bashkinë Kamëz. Ky fakt, shoqërohet me probleme të shëndetit

PLANIFIKIMI I REHABILITIMIT

Plani i rehabilitimit përshkruan procesin sistematik të identifikimit të mosfunksionimit të menaxhimit të mbetjeve në Njësine Administrative Rurale Laknas, Bashkia Kamëz, zhvillimin e një

plani veprimi për të rregulluar mosfunksionimin, si dhe zbatimin e një strategjie korrigjuese të integruar në mënyrë që të krijojë zgjidhje më efikase, të stabilizojë menyrën e menaxhimit të mbetjeve dhe të reduktojë ndotjen prej tyre.

Nevoja për rehabilitim nuk duhet të justifikohet me kosto-përfitim ose prova shkencore dhe teknologjike, por mbështetet në një gjykim për të mbështetur kapitalin natyror për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

QËLLIMET KRYESORE TË REHABILITIMIT

1. Identifikimi i problemit. (VLERËSIM)
2. Krijimi i një zgjidhje të strukturuar për problemin. (KRIJIMI I PROGRAMIT TË PËRMIRËSIMIT)
3. Zbatimi i zgjidhjes së strategjisë. (VEPRIM KORRIGJUES)
4. Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik.
5. Përmirësimi i peizazhit të zonës së Laknasit dhe jetës së banorëve të tij.
6. Ruajtja e burimeve natyrore duke menaxhuar mbetjet urbane.

QËLLIMET SPECIFIKE

1. Zhvillimi i një skeme të përshtatshme për largimin dhe transportin e mbetjeve në destinacionin final.
2. Zbatimi i një sistemi lokal të trajtimit të mbetjeve për të reduktuar volumnin e mbetjeve të deponuara dhe për të minimizuar përdorimin e burimeve natyrore si vend-grumbullim i tyre.
3. Mbyllja e vend-grumbullimeve të pakontrolluara dhe venddepozitimeve që nuk janë në përputhje me kërkesat.
4. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbetjeve.

2. KONCEPTE KRYESORE

Vend-depozitimet ilegale, në këtë raport, janë përcaktuar si depozitimet e mbetjeve urbane në zona ku nuk ekziston asnjë leje, licencë apo miratim nga institucionet vendimarrëse për depozitim të tyre.

Vend-depozitimet ilegale - Burim. I referohet hedhjes së qëllimshme të sasive të mëdha të mbetjeve shtëpiake, materialeve të ndërtimit apo inerte dhe objekteve, të tilla si: gomat, pajisje dhe mobilje, përgjatë lumit. Janë quajtur *burim* pasi janë burim ndotjeje për shkak të afërsisë së tyre me lumenjtë dhe prirjen t'i marrë rrjedha gjatë stinës së dimrit.

Vend-depozitimet ilegale - Rastësore. I referohet mbetjeve të cilat janë të grumbulluara në zona të caktuara në mënyrë rastësore të sjella aty për shkak të rrjedhës së ujit të lumit.

3. KUADRI LIGJOR (SHQIPTAR)

- **Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011** "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- **Ligj Nr. 10119, datë 23.04.2009** "Për planifikimin e territorit".
- **Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002** "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006** "Për mbrojtjen e biodiversitetit".

- **Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003** "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- **Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012** "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".
- **Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005** "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve".
- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005** "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse".
- **Vendim Nr. 16, datë 14.01.2012** "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor".

4. KUADRI LIGJOR (EUROPIAN)

Plani i rehabilitimit në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat më kryesore:

- **Direktiva 2000/60/EE** e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave.
- **Direktives KE 42/2001** (të Këshillit të Europës), mbi VNM dhe VSM.
- **Direktiva 2008/50, EE**, e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër me të pastër për Europën".
- **Direktiva 75/442/EE** e Këshillit të Europës e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- **Direktiva 91/689/EE** e Këshillit të Europës e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- **Direktiva 2001/42/EE** e Këshillit të Europës dhe e parlamentit European e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- **Direktiva 85/337/EE** e Këshillit të Europës e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- **Direktiva e Këshillit 96/62/EE** Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.

5. SITUATA E VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE BURIM NË ZONËN E LAKNASIT

Vendndodhja e vend-depozitimeve të mbetjeve ilegale Burim në zonën e Laksanit
Burimi: ENFORCE Albania

VEND-DEPOZITIMET E IDENTIFIKUARA (SHTATOR 2022)

Për të arritur qellimin e këtij plani, Grupi ENFORCE Albania, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pastrim - Gjelbërim dhe Treg, Bashkia Kamëz, kanë ngritur një grup pune të përbashkët për të bërë të mundur, edhe një herë, identifikimin e vend-depozitimeve ilegale ekzistuese. Duke qenë se inxhinierët e kësaj drejtorie kanë eksperiencë në lidhje me sasinë e mbetjeve që mund të jenë akumuluar në këto vend-depozitime, janë shtuar disa të dhëna më specifike që lidhen me sasinë e mbetjeve në këto vend-depozitime, si dhe numrin e kamionave të nevojshëm për të bërë të mundur largimin e të gjithë sasisë së mbetjeve.

Për sa i përket planit të rehabilitimit, janë identifikuar numri i kontenierëve të nevojshëm për tu vendosur në zonat e afërta të këtyre vend-depozitimeve, zonat ku është e mundur mbjellja e vegjetacionit, si dhe zonat ku është e nevojshme ndërhyrja për punime për shtratifikimin e skarpateve të lumit.

Më poshtë janë paraqitur vend-depozitimet ilegale të identifikuar nga bashkëpunimi ENFORCE Albania dhe Ndërmarrja Pastrim - Gjelbërim dhe Treg, Bashkia Kamëz.

<u>Nr.</u>	<u>Vend-depozitimi</u>	<u>Koordinatat</u>	<u>Karakteristikat</u>
<u>Nr.1</u>		41.362596, 19.761194	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~30 m2 Sasia e mbetjeve: ~ 2 Ton

<u>Nr.2</u>		41.362979, 19.760811	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~30 m2 Sasia e mbetjeve: ~ 2 Ton
<u>Nr.3</u>		Koordinata: 41.36347, 19.76008	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~10 m2 Sasia e mbetjeve: ~ 200 kg
<u>Nr. 4</u>		Koordinata: 41.364649, 19.759380	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~ 150 m2 Sasia e mbetjeve: ~ 700 kg

<u>Nr. 5</u>		Koordinata: 41.368259, 19.759007	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja:~10 m2 Sasia e mbetjeve: 3 ton
<u>Nr. 6</u>		Koordinata: 41.36753, 19.75936	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~250m2 Sasia e mbetjeve: 10 Ton
<u>Nr. 7</u>		Koordinata: 41.369855, 19.756349	Dominojnë mbetjet urbane (plastika, qelqi, mbetje organike, etj.) Sipërfaqja: ~ 100 m2 Sasia e mbetjeve: ~ 3 Ton

<u>Nr. 8</u>		Koordinata: 41.376769, 19.742983	Sipërfaqja: ~ 50m² Sasia e mbetjeve: ~6 ton
<u>Nr. 9</u>		Koordinata: 41.385303, 19.733930	Sipërfaqja: ~ 100m² Sasia e mbetjeve: ~50 ton
<u>Nr.10</u>		Koordinata: 41.385762, 19.734054	Sipërfaqja: ~35m² Sasia e mbetjeve: ~5 ton
<u>Nr.11</u>		Koordinata: 41.378452, 19.739125	Sipërfaqja: ~500-600 m² Sasia e mbetjeve: ~200 ton

*Të dhëna të grumbulluara nga vizitat në terren (Shtator 2022)

6. PLANI I MBYLLJES DHE REHABILITIMIT TË VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE BURIM

Plani i Mbylljes dhe Rehabilitimit synon të promovojë shëndetin publik, duke arritur një ekuilibër të qëndrueshëm ekologjik. Ai kërkon në mënyrë specifike të arrijë sa vijon:

- Të krijojë strategji dhe parametra të zbatueshëm për mbylljen e duhur dhe rehabilitimin e vend-depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane në zonën rurale të Laknasit.
- Për të konstatuar kërkesat e mbylljes dhe orarin e aktiviteteve rehabilituese bazuar në kushtet aktuale të vend-depozitimeve.
- Të alokohen burime për realizimin e planit të sigurt të mbylljes dhe rehabilitimit.
- Të promovojë një mënyrë efikase për menaxhimin e mbetjeve
- Të përshpejtojë vënien në zbatim të planit efikas të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonë.

Këto objektiva mund të përmbushen duke siguruar udhëzimet e duhura teknike dhe standardet që janë përdorur në fillim për planifikimin e mbylljes së vend-depozitimeve ilegale.

Objektivat e hollësishme të rehabilitimit janë të renditura në tabelën më poshtë, me një përshkrim të elementeve, brenda secilit artikull.

OBJEKTIVAT	
Mbrojtje Dhe Siguri	Rehabilitimi duhet të ofrojë: • Një mjedis të sigurt për banorët e Laknasit, florën dhe faunën. • Stabilizimi i zonës (largimi i mbetjeve,) në mënyrë që të mos ketë asnjë rrezik, pas mbylljes përfundimtare të vend-depozitimeve ilegale;
Menaxhimi i Efekteve Mjedisore	• Kontrolli i erozionit, • Kontrolli i cilësisë së ujërave sipërfaqësor/nëntokësor dhe minimizimi i efekteve afatgjata mjedisore; • Pastrimi, trajtimi ose restaurimi i zonave të kontaminuara.

Pastrimi i Vendndodhjes	• Heqjen dhe largimi i mbetjeve nga subjekte të kontraktuara apo nga vetë Bashkia Kamëz. • Vendosja e kontenerëve me ngjyra, me qëllim diferencimin që në burim të mbetjeve të gjeneruara në këtë zonë.
Mbrojtja Nga Erozioni	• Stabilizimi i zonave të cilat janë të mbetjeve në impiant. • Shtimi i sipërfaqeve të mbjella, për të minimizuar erozionin nga era dhe sidomos nga uji (duke qënë se zona e studiuar ndodhet shumë pranë Lumit Ishëm).
Mbulesa bimore	• Sigurimi i kushteve të vendit për të mundësuar fillimin e 'pushtimit' natyror të bimësisë indigjene në vend; • Krijimi i një baze vegetative që do të mundësojë speciet natyrore, për të filluar procesin e rimëkëmbjes, drejt cilësisë dhe produktivitetit të mjedisit.
Estetike	1. Objektivat përfshijnë peisazhin e zonës së shfrytëzuar, përmirësimin e pamjes estetike, sipas nevojës dhe në përputhje me skenarët e përcaktuar, pas përdorimit për peisazhin.

6.1. PLANI I MBYLLJES

Elementi kyç i masave të mbylljes dhe rehabilitimit të vend depozitimit, sipas Direktivës së BE-së për Vend-Depozitimet, është izolimi i sipërfaqes i projektuar si duhet, me qëllim që të parandalojë gjenerimin e lëngut kullues, duhet të ketë shtresë të kullimi të gazit, shtresë minerale të papërshkrueshme, shtresë kullimi dhe shtresë mbulimi të sipërme dherash. Për shkak të madhësisë dhe ndikimit të pritshëm në mjedis vendgrumbullimet ekzistuese, mund të ndahen në kategori të ndryshme. Përveç ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga gazi i vend-depozitimit, lëngu kullues, aromat e rënda dhe parazitët, duhet të merren në konsideratë edhe ndikimet e jashtëzakonshme mjedisore, si distanca deri në vendbanimin më të afërt, distanca deri në një trup ujqor (liqen, lumë apo kanal kullimi) dhe distanca deri tek pusët e ujit.

6.1.1. OPSIONI PËR MBYLLJEN E VEND-DEPOZITIMEVE ILEGALE

Nisur nga karakteristikat e secilit vend-depozitim (sipërfaqja e zënë me mbetje, lloji i mbetjeve, sasia e tyre, afërsia me burimet ujore përgjatë zonës së studiuar/analizuar), lind nevoja urgjente që së pari të kryhet largimi i këtyre mbetjeve.

Për këtë ofrohen 2 (dy) opsione të mundshme:

1. Transportim në Landfillin e Sharrës.
2. Transportim në ndonjë pikë transferimi të mbetjeve

***** Në asnjë rast nuk sugjerohet që të aplikohet praktika e mbulimit të mbetjeve me dhë.**

Kjo për disa arsye:

1. Sasia e mbetjeve të grumbulluara është e madhe;
2. Afërsia me lumin Ishëm;
3. Kontribujon në ndotje të mjedisit tokësor;
4. Distanca e afërt me Landfillin e Sharrës.

TRANSPORTI NË LANDFILLIN E SHARRËS

Landfilli i Sharrës ndodhet në një distancë mesatarisht 18.6 km nga zona rurale e Laknasit. Kjo konsiderohet një distancë e afërt, prandaj vlerësohet se dërgimi i mbetjeve të grumbulluara në vend-depozitimet me Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10 në Landfill është opsioni më i mirë.

Transportimi i mbetjeve do të kryhet me kamiona të cilët sigurohen nga Bashkia Kamëz ose nëpërmjet subjekteve të kontraktuara prej saj.

Bashkia Kamez ka në përdorim këto mjete teknologjike:

1 - Fadromë

Marka:-JBC

Viti i prodhimit:-2004

Fuqia:-4x4 me 3 lloje kovash

2 - Dy Kamiona me 3 akse

Marka:-Iveko

Kapaciteti i mbajtjes:-7 deri në 9 ton

Viti i prodhimit:-2010

- Një makinë teknologjike transportuese për mbetje me ngarkim anësor ose fundor.

Viti i prodhimit:-2010

3 - Një kamioncinë

Marka:-IVECO

Kapaciteti i mbajtjes:-4-6 ton me dy akse

Viti i prodhimit:-2000

TRANSPORTI NË NDOJË PIKË TRANSFERIMI TË MBETJEVE

Për vend-depozitimet Nr. 9 dhe 11, vlen të theksohet se janë vend-depozitimet me sasinë më të madhe të mbetjeve të depozituara dhe që zënë sipërfaqen më të madhe, vlerësohet se zgjidhja është transporti në ndonjë pikë transferimi të mbetjeve.

Sepse duke bërë transportim në një pikë transferimi, ku kryhet seleksionim, një sasi e vogël mbetjesh mbetet për në landfill.

Aktiviteti i *Transferimit dhe Transportimit të Mbetjeve* në një Stacioni Transferimi të Mbetjeve ka nevojë për aftësi menaxheriale dhe teknike:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Planifikimi i transportimit të mbetjeve, përfshirë sistemin e rrugës për në/nga stacionet e transferimit;
- Përdorimi i instrumenteve financiare;
- Mirëmbajtja parandaluese dhe korigjuese;
- Menaxhimi i aseteve;
- Vlerësimi i riskut dhe reagimi i shpejtë;
- Monitorimi dhe raportimi.

Nëse punësohet staf me kualifikimet e lartë-përmendura mund të realizohet një sistem i optimizuar i transferimit dhe transportit të mbetjeve nga banesat në vend depozitim nëpërmjet stacioneve të transferimit.

MJETET TEKNOLOGJIKE TË NEVOJSHME PËR LARGIMIN E VEND-DEPOZITIMEVE

Vend-depozitimi ilegal	Sasia (Ton)	Kamiona (Kapaciteti ~ 8 ton)	Fadrome	Opsionet per Depozitim Final
Nr. 1	~ 2	1 Kamion	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 2	~ 2		Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 3	~ 0.2		Jo	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 4	~ 0.7		Jo	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 5	~ 3		Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 6	~ 10	1 Kamion	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 7	~ 3	1 Kamion	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi

Nr. 8	~ 6		Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 9	~ 50	6 Kamiona	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 10	~ 5	1 Kamion	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Nr. 11	~ 200	25 Kamiona	Po	☐ Landfill ☐ Stacion Trasferimi
Total	281.9	35		

6.2. PLANI I REHABILITIMIT

PROCESI I REHABILITIMIT

Në lidhje me rehabilitimin e territorit pas largimit të mbetjeve, janë marrë disa masa, paraqitur si më poshtë.

- 1. Të realizohet stabilizimi fizik i sipërfaqeve, të zëna më parë nga vend-depozitimet ilegale të mbetjeve.**

Stabilizimi fizik i sipërfaqeve konsiston në sheshimin e gropave të krijuara nga mbledhja e mbetjeve me anë të fadromës. Gjithashtu edhe dhënia e një gradienti pjerrësie për të zbutur erzionin uhor dhe për të krijuar bazament për mbjelljen e pemëve.

- 2. Pas pastrimit të sipërfaqeve, të vendoset sinjalistika e ndalimit për lëvizjen e mjeteve, personave jo të autorizuar, deri në rehabilitimin e zonës.**

Kjo praktikë ndiqet me qëllim parandalimin e ndonjë aksidenti të mundshëm, evitimi i bllokimit të rrugëve dhe vazhdimësisë së punës.

- 3. Rehabilitimi i rrugëve hyrëse-dalëse.** Pas largimit të mbetjeve, të bëhet bllokimi i rrugëve me gardhe në të gjithë perimetrin hyrës.

- 4. Të vendosen kontenierë me ngjyra dhe me shënim për tipin e mbetjes që duhet të depozitohet aty, duke bërë të mundur ndarjen e mbetjeve sipas kodeve dhe morfologjisë së tyre që në burim.**

Kontenierët do të jenë të tipit metalik/plastik, me një kapacitet mbajtës prej ~ 0.5 Ton mbetje. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i kontenierëve për secilin vend-depozitim.

Vend-depozitimi	Numri i kontenierëve
-----------------	----------------------

Nr. 1	4 kontenier (2 për mbetjet e riciklueshme dhe 2 për mbetje të tjera)
Nr.2	
Nr. 3	
Nr. 4	
Nr. 5	4 kontenier (2 për mbetjet e riciklueshme dhe 2 për mbetje të tjera)
Nr. 6	
Nr. 7	
Nr. 8	2 Kontenier (2 për mbetjet e riciklueshme dhe 2 për mbetje të tjera)
Nr. 9	4 kontenier (2 për mbetjet e riciklueshme dhe 2 për mbetje të tjera)
Nr. 10	Ekzistojnë 2 copë, duhet të shtohen edhe 2 të tjerë
Nr. 11	Ekzistojnë 2 copë, duhet të shtohen dhe 2 të tjerë

***** Pastrimi i kontenierëve nga mbetjet si dhe larja e tyre të bëhet çdo ditë në oraret e përshtatshme kur nuk ka lëvizje të njerëzve, në mënyrë që të mos krijohen shqetësime nga zhurmat apo aromat.**

5. Mbjellja me bimësi (mundësisht autoktone të zonës).

Pas realizimit të objektivave të mësipërme, hapi i fundit që duhet të ndiqet është mbjellja e sipërfaqeve me bimësi, mundësisht autoktone.

Realizimi i mbjelljes së “tapetit të gjelbër”.


Pas ngjeshjes dhe nivelimit të sipërfaqeve, sipërfaqja e sheshit do të shkrifërohet me krëhër dhe duhet të mbillet me farë bari (lilolium ose farë bari nga bimët barishtore të zonës). Kjo bimësi duke qenë me sistem rrënjor-xhufkor dhe të luajë rolin e stabilizuesit biologjik të masës së dheut në fazën e parë të riaftësimit të tokës dhe fillimin e zhvillimit të proceseve fillestare të formimit të strukturës së tokës dhe raportet ajër-ujë të aggregateve tokësore dhe poreve. Në këtë fazë mund të kryhet dhe mulçinim modest i sipërfaqes së mbjellë me një shtrese të hollë plehu organik dhe mbulesë vegjetale.

Mbjellja e fidanëve dhe bimësisë shkurre.

Ky operacion duhet të bëhet pas një periudhe kohe të caktuar nga sistemimi i dheut. Mbjellja e bimësisë autoktone në sipërfaqen e shtruar më parë do të bëjë të mundur stabilizimin e zonës së shfrytëzuar, mbrojtjen nga erozioni, si dhe rregullimin e peisazhit të zonës.

Pemët që vlerësohet të përdoren në zonë janë shoqërime bimore të tipit shqopë (*Erica arborea*), mërsinë (*Myrtus communis*), shkozë e zezë (*Carpinus orientalis*), Akacia (*Robinia pseudoacacia*), Plepi (*Populus sp.*).





Robinia pseudoacacia


Në rastin e mbjelljes do të përdoret skema me përmasa 4x6 m deri në 8-10 m. Për të arritur këtë qëllim mbetet e angazhuar Bashkia Kamëz të bëjë çdo investim dhe të marrë masat e përcaktuara më lart për të realizuar rehabilitimin e sipërfaqeve të zëna më parë nga vend-depozitimet ilegale përgjatë Lumit Ishëm.

SKEMAT E MBJELLJES

Bëhet në varësi të relievit dhe të shkallës së mekanizimit të saj.

1. **Forma katrore.** Në këtë skemë largësia e bimëve është e barabartë ndërmjet tyre, si midis rreshtave ashtu edhe midis bimëve në rresht. Kjo realizohet kryesisht në tokat me reliev fushor.
2. **Forma katërkëndëshi-këndrejtë.** Edhe kjo skemë mbjelljeje realizohet në tokat fushore. Në këtë rast largësia/hapësira e rreshtave është më e madhe se ajo e bimëve në një rresht. Rreshtat duhet të drejtohen në drejtimin Veri-Jug, me qëllim që të ndriçohen sa më mirë nga dielli.

Kur mbillet në territor me pjerrësi më të vogël se sa 10-120°, duhet që rreshtat të mbillen përpjendikular me pjerrësinë (ose e thënë ndryshe paralel me izoipset)



Skemat e mbjelljes

Piketimi i gropave. Gropat piketohen sipas formave të shpjeguara më sipër. Piketimi bëhet me metër shirit.

Nuk këshillohet me litar apo spango, sepse gjatë kalimit nëpër bar të lagur me vesë apo ujë nga reshjet, zakonisht shkurtohen/tkurren dhe prishen distancat e shënuara.

PROGRAMI I PROPOZUAR I AKTIVITETEVE PËR ZBATIMIN E KËTIJ PLANI

Komponentët	Aktivitetet	Kohëzgjatja (Muaj)
-------------	-------------	--------------------

<i>Mbyllja dhe Rehabilitimi</i>		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	<i>6</i>
Mbyllja	<i>Pastrimi i vend-depozitimeve (1,2,3,4,5,6,7,8,10) dhe transporti në destinacionin Final</i>						
	<i>Pastrimi i vend-depozitimive (Nr. 9 dhe 11) dhe transporti në destinacionin Final</i>						
Rehabilitimi	<i>Punime për krehjen dhe sistemimin e gjithë sipërfaqeve të zëna më parë nga mbetjet</i>						
	<i>Vendosja e kontenierëve me ngjyra</i>						
	<i>Punime për shtratifikimin e skarpateve të lumit</i>						
	<i>Mbjellje fidanësh</i>						